



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 31 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtësit të Salih Mustafës:

Julius von Bone

Mbrojtëses së Viktimave:

Ani Pues

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 46 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullave 172, 173(1) dhe 194(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), cakton Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me lëshimin e një vendimi të ri dënimi për z. Salih Mustafa ("z. Mustafa") në përputhje me Vendimin mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë ("Vendimi për Mbrojtjen e Ligjshmërisë").¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykues I shpalli Aktgjykimin ("Aktgjykimi"), ku, ndër të tjera, e dënoi z. Salih Mustafa për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje si krime lufte dhe e shpalli të pafajshëm për trajtim mizor si krim lufte.² Trupi Gjykues e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.³

2. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi Aktgjykimin e Apelit ("Aktgjykimi i Apelit") me të cilin la në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por miratoi pjesërisht apelin e z. Mustafa kundër dënimit të tij.⁴ Për këtë qëllim, Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁵

3. Më 14 mars 2024, z. Mustafa dorëzoi Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtjen e Ligjshmërisë me Shtojcat 1 dhe 2 konfidenciale sipas Nenit 48(6) deri (8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores ("Kërkesa").⁶

4. Më 29 korrik 2024, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi Vendimin për Mbrojtjen e Ligjshmërisë lidhur me Kërkesën e z. Mustafa. Paneli i Gjykatës Supreme, ndër të tjera “d) anuloi Aktgjykimin e Apelit në lidhje me dënimin e z. Mustafa [dhe] e) ia ktheu Aktgjykimin e Apelit Panelit të Apelit për të marrë një vendim të ri në bazë të rregullës 194(1)(b) të Rregullores”.⁷

II. CAKTIMI

5. 5. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA CAKTON:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur për një dënim të ri për z. Mustafa në pajtim me Vendimin për Mbrojtje të Ligjshmërisë dhe për të vendosur për çdo aspekt tjetër përkatës, sipas rastit.

¹ KSC-SC-2024-02/F000018, Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 29 korrik 2024.

² KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykim, dorëzuar më 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023 dhe versioni i redaktuar publik më 8 qershor 2023.

³ Aktgjykimi, para. 831.

⁴ KSC-CA-2023-02/F00038, Aktgjykimi i Apelit, 14 dhjetor 2023 (konfidencial), para. 484. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të Apelit u dorëzua më të njëjtën ditë (KSC-CA-2023-02/F00038/RED).

⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

⁶ KSC-SC-2024-02/F00011, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2, sipas nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores, 14 mars 2024.

⁷ Vendimi për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 112.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 31 korrik 2024
Në Hagë,
Holandë